

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot me date 21/10/2022 ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate si me poshte vijon:

PALA SHITESE :

- **Z.FLORIM LIMA**, lindur dhe banues ne Kosove, me 30.11.1975, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar dentifikuar nepermjet kartes Id me nr. H 51130157 L. **Perfaqesuar me Prokure te Pergjithshme nga Z.Gent Xhetani**
- **Z.GENT XHETANI**, lindur ne Derjan, Mat dhe banues ne Tirane, me 06.04.1977, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet Passaportes Biometrike me nr. H70406070N,

PALA BLERESE :

- **Z.Ardit Xhetani**, lindur ne Derjan, Mat dhe banues ne Tiirane me 30.10.1977, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet ID H7030041S.

TE PERGJITHSHME

- 1- Shitesit Florim Lima dhe Gent Xhetani jane ortake dhe zoterojne 100% te kapitalit themeltar te Shoqërisë “**M & SILLOS ALBANIA**” Sh.p.k, me seli ne TIRANE, Njesia Nr. 7, Rruga Muhamet. Gjollësia, Sheshi Karl Topia, Pallat Tirana Ring Center, Hyrja 2, Kati 9, Apartamenti B22. (**më poshtë referuar si shoqëria.**)
- 2- Shoqëria është rregjistruar pranë QKB-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS L82205028R** me objekt veprimtarie :
“Kryerja e aktiviteteve te nderntjetesimit ne nenshkrimin e Kontratave me te trete, persona fizik apo juridik, vendas dhe/ose te huaj. Agjent shitjeje dhe komisioner per sherbimet dhe mallrat e nclryshme, qe ofrohen ne favor te paleve te treta. Kompania gjithashtu mund te marre perfaqesime ose agjensi, me qellim te investimit direkt ose indirekt ne kompani te tjera. Ofrimi i asistences duke perfshire sherbimet e menaxhimit, keshillimin, planifikimin, financat etj. Te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme ose ato te paluajtshme dhe cdo aktivitet tregtar, duke vene peng apo hipoteke, aktivite keto te cilat

konsiderohen te dobishme ose te nevojshme per te arritur qellimin kryesorte Kompanise. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, per te arritur objektivat e mesiperme, Kompania/ Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari tjeter qe nuk eshte e ndaluar nga ligji ne fuqi, fitimprures dhe ne interes te Kompanise. Kompania zbaton dhe respekton te gjitha ligjet dhe rregulloret perkatese. Zbaton standardet me. te larta te etikes”.

- Kapitali themeltar i shoqërisë “M & SILLOS ALBANIA” Sh.p.k është 100 lek dhe zotërohet nga dy ortake:
 - Florim Lima i cili zoteron 1 kuote me vlere 80 Lek e cila perben 80% te kapitalit themeltare te Shoqerise “M & SILLOS ALBANIA”;
 - Gent Xhetani i cili zoteron 1 kuote me vlere 20 Lek e cila perben 20% te kapitalit themeltar te Shoqërisë “ M & SILLOS ALBANIA”.

Neni 1 Objekti


Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate. Shitesi Florim Lima zoterues i 80% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe Gent Xhetani zoterues i 20% te kapitalit themeltar te shoqerise, i kalojn bleresit Ardit Xhetani 100 % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.

Neni 2 Kalimi i pronësisë mbi kuotat

Kalimi i pronësisë te kuotave te kapitalit themeltar, do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kesaj kontrate shitje kuotash nga Z.Florim Lima dhe Z.Gent Xhetani si pale shitese dhe Z. Ardit Xhetani si pale blerese.

Neni 3 Çmimi i shitjes se kuotave

Vlera e shitjes se kuotes qe zoteron Z. Florim Lima do te jete 80 (tetedhete) Lek dhe vlera e shitjes se kuotes qe zoteron Z.Gent Xhetani do te jete 20 (njetete) Lek. Pala blerese Z.Ardit Xhetani eshte plotesisht dakort me cmimin e percaktuar nga shitesit e kuotave.



Neni 4
Garancitë

Shitesit në lidhje me kuotat që zotërojnë, garantojnë bleresin se :

- Jane pronare te vetem te kuotave respektive.
- Në të njëjtën kohë garantojnë dhe sigurojnë palën blerese se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuotat jane te lira nga çdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
- Nuk jane objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
- Jane te lira nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;
- Ortaku, qe pengohet te ushtroj te drejtat qe i rrjedhin nga zotrimi i kuotes se shoqerise , ka te drejte t'i kerkoj gjykates te urdhroj ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoj e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

Neni 5
Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga neni 73, 74 ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 6
Regjistrimi

- Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKR-së në bazë të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, shoqëria “**M & SILLOS ALBANIA**” Sh.p.k do të ketë ortak te vetem Z. Ardit Xhetani, i cili do te jete zoterues i 1 kuote me vlere 100 Lek, e cila perben 100% kapitalit themeltar te shoqerise. :
- Ne castin qe kjo kontrate regjistrohet ne QKB ne zbatim te Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”- i ndryshuar, pergjesite apo

detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave i kalojne ne menyre solidare dhe unanime Z.Ardit Xhetani.

Neni 7

Shpenzimet

Të gjitha taksat, tatimet si dhe shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhen nga pala përkatëse sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Palët në këtë kontratë nuk mund ti kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

Neni 8

Interpretimi i Kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9

Njoftimi zyrtar midis palëve

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do te jete **Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.**

Neni 11

Hartimi i Kontratës

Kjo kontratë hartohet në 4 (kater) njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe 1(një) njësi depozitohet pranë QKR-së .

Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojmë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë, të plotë dhe te pavarur, e nënshkruajmë atë rregullisht ne te gjitha kopjet .

PALET KONTRAKTUESE

Shitesit e kuotave

Z. Florim Lima , perfaqesuar me prokure
te pergjithshme nga Z. Gent Xhetani.



GENT XHETANI

BLERSI I KUOTAVE

GENT XHETANI

Z. ARDIT XHETANI

ARDIT XHETANI